

STATUTI

Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë

Raiffeisen – Leasing Gesellschaft m.b.H. dhe Znj. Adelheid Gerwing kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me emërtimin-----
Raiffeisen – Leasing International Gesellschaft m.b.H.

Neni 2 Selia e Shoqërisë

Shoqëria do të ketë selin e saj në Vjenë, Austri.
Shoqëria mund të formojë degë në Austri dhe në vende të tjera.

Neni 3 Qëllimet e Shoqërisë

Qëllimet e shoqërisë janë:

- a. Të marri, të krijojë dhe menaxhojë asete të luajtshme dhe të paluajtshme në Austri dhe jashtë saj me qëllim kryerjen e operacioneve të qiradhënies dhe lisingu, veçanërisht për të fituar pasuri të paluajtshme dhe të drejta të tjera equivalente, të ndërtojë objekte mbi këto pasuri të paluajtshme për qëllime shfytëzimi dhe tregtare duke e dhënë në leasing këto pronësi dhe të drejtat ekuivalente ashtu si dhe ndërtesat;
- b. Të marri pjesë ose pjesëmarrje në ndërmarrje me të njëjtat qëllime si është parashikuar në paragrafin a) më lartë; dhe
- c. Të veprojnë si agent në lidhje me transaksionet e kontraktuar nga të tjerët.

Shoqërisë nuk i lejohet të kryejë ndonjë transaksion bankar në kuptimin e parashikimeve statutore.

Neni 4 Kapitali dhe Pjesët e Kapitalit

Kapitali i shoqërisë është i barabartë me Euro 36.333,42 (tridhjetë e gjashtë mijë e treqind tridhjetë e tre presje dyzetë e dy) prej të cilave gjysma është paguar në kesh. Pjesa e çdo ortaku është e barabartë me pjesën përkatëse në kapital.

Neni 5 Pjesë e kapitalit

Tranferimi, pjesëtimi dhe lënia peng e pjesëve të kapitalit bëhet me miratimin e ortakëve.

Neni 6 Kohëzgjatja dhe Peridha Ushtrimore

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar në kohë. Periudha e parë ushtrimore fillon me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar dhe mbaronë me 31 dhjetorin e parë. Pas kësaj çdo periudhë financiare fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 dhjetorin pasardhës.

Neni 7 Organet e Shoqërisë

Organet e shoqërisë janë bordi i drejtorve dhe asambleja e ortakëve.

Neni 8 Bordi i Drejtorve

Shoqëria do të ketë të paktën dy drejtor. Shoqëria do të përfaqësohet nga dy drejtorët ose nga një prej drejtorve së bashku me një përfaqësues me prokurë, duke vepruar bashkarisht. Përfaqësimi i shoqërisë nga dy përfaqësues më prokurë, që veprojnë bashkarisht, lejohet dhe është subjekt i kufizimeve të përcaktuara në ligj. Përfaqësuesve me prokurë nuk mund tu jepet kompetenca për të vepruar veçmas.

Neni 9 Asambleja e Ortakëve

1. Asambleja e Ortakëve do të kërkohet prej drejtorëve ekzekutiv ose një ortaku. Asambleja e Ortakëve do të mbahet në Vienë ose në kryeqytetin e një prej provincave federale te Austrisë.
2. Vendimet e asamblesë së ortakëve mund të merren me shumicë të zkonshme, përveçse kur me ligj kërkohet me shumica të zakonshme.
3. Nëse në ndonjë rast të gjithë ortakët japin miratim me shkrim për një vendim, ose të paktën për marrjen e një vendimi me shkrim, ky vendim mund të merret me shkrim, me kusht që për këto vendime shumica e kërkuar nuk do të jetë shumica e votave të mbledhura, por shumica e votave të gjithë ortakëve.
4. Cdo 1 (një) euro cent e kapitalit të ortakëve korespondon me një votë, por cdo ortak duhet të ketë të paktën një votë.

Neni 10 Deklaratat Financiare Vjetore

- (1) Drejtorët ekzekutiv brënda pesë muajve të parë të çdo viti financiar, do të përgatisin deklaratat financiare vjetore të vitit financiar paraardhës.

(2) Cdo vit Asambleja e ortakëve do të marrë një vendim në lidhje me aprovimin e deklaratave financiare vjetore, shpërndarjen e përfitimeve neto, dhe mbi vendimet e drejtorëve ekzekutiv për vitin financiar parardhës (asambleja vjetore e ortakëve)

(3) Asambleja e ortakëve mund të vendos me unanimitet mbi një shpërndarje të fitimeve që nuk është në përpjestim me pjesmarjen e tyre në kapital.

Neni 11 Dispozita të tjera

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga kjo kontratë, do të zbatohetn dispozitat e Aktit Australian mbi Shoqëritë me Përgjegjësi të kufizuar dhe ligjet të tjera të aplikueshme.

Me kontrollin e sotëm të dosjes nr. FN 157024v të Raiffeisen-Leasing International Gesellschaft m.b.H. në Regjistrin e Shoqërive të Gjykatës Tregtare të Vienës, unë me anë të kësaj vërtetoj në përputhje me seksionin 9 b të Aktit të Noterit Public që formulimi dhe format e Neneve të Statutit të dhëna këtu më sipër pajtohen me kopjen originale aktualisht të skeduar në Regjistrin e Shoqërive.

Vienë, 28 (njëzetë e tetë) Shkurt 2006 (dy mijë e gjashtë)

Dr. Christoph Bieber
Noter publik
Vienë-Qyteti I Brëndshëm

Vulë:
(nënshkrim i palexueshëm)
Noter Publik

Në mirëbesim me anë të kësaj
Vërtetoj që sa më lartë është një
Përkthim i rregullt i tekstit Gjermanisht
bërë prej meje.

Vienë, 3 Mars 2006

Vula

VËRTETIM

Sot, më datë 09.05. 2006, unë e nënshkruara, Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980 dhe banuese në Tiranë, Rr. Kavaja, P. 138, me pasaportë nr. Z 1347741, vërtetoj që deklarova se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me origjinalin i versionit anglisht dhe anasjelltas.

PËRKTHYESE

Gentiana Koduzi
Gentiana Koduzi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 2783 REP.

PULLE TAKSE



VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më datë 09.05. 2006, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres *Mimoza Sadushaj*, u paraqit personalisht Znj. Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980 dhe banuese në Tiranë, Rr. Kavaja, P. 138, me pasaportë nr. Z 1347741, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u binda pasi verifikova pasaportën e saj, e cila më deklaroi se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me origjinalin i versionit anglisht dhe anasjelltas, vërtetim të cilin e nënshkroi përpara meje noteres, me vullnetin e saj të plotë dhe të lirë, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE



NOTERE
Mimoza Sadushaj
TIRANË